

KARTELË INFORMATIVE				
				AL112011
1. Emri i shërbimit	Regjistrim për kurs formimi profesional			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Ky shërbim vlen për të fituar aftësi profesionale të certifikuara			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Regjistrimin e njerëzve të cilët kërkojnë të ndjekin kurse formimi profesional në Qendrat e Formimit Profesional Publik			
4. A jam përfitues?	1. Punëkërkuar të papunë të regjistruar në zyrat e punësimit që janë pa profesion dhe kërkojnë të fitojnë një të tillë, apo kanë një profesion që nuk kërkohet nga tregu i punës dhe duan ta ndryshojnë atë. 2. Të punësuar apo nxënës shkolle që duan të plotësojnë njohuritë e tyre në një fushë të caktuar. 3. Të burgosurit që gjatë periudhës së dënimit duan të fitojnë një profesion. 4. Shtetas të huaj me leje qëndrimi në Shqipëri që duan të formohen profesionalisht.			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Fotokopje e kartës së identitetit	Aplikanti	Po
	2	Fotokopje e diplomës/ dëftesa e shkollës	Institucioni arsimor	Po
	3	Mandatpagesa (nëse nuk është punëkërkuar i papunë)	Bankë	Po
	4	2 (dy) fotografi	Aplikanti	Po
	5	Fletën e drejtimit për formim profesional (nëse është punëkërkuar i papunë)	Institucioni	Po
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Online në portalin e- Albania; 1. Zyrat Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (ZRSHKP); Zyrat Vendore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (ZVSHKP) 2. Qendrat e Formimit Profesional Publik *Për të marrë informacion për kurset, kërkoni në faqen online të Shërbimit Kombëtar të Punësimit	Kudo ku ka qytetarë shqiptarë; 1. Në çdo qytet ku ka zyrë punësimi 2. Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Korçë, Qendra e lëvizshme për zonën verilindore	Online në portalin e-Albania.al; 1. Zyrat Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (ZRSHKP); Zyrat Vendore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (ZVSHKP) 2. Durrës - lagja Nr. 17, rruga "P. Sorro", (ish URT) Elbasan - lagjia "Shënkoll" Fier - lagjia "16 prilli", rruga "Llukan Toska" (ish fabrika e fermentimit të duhanit) Gjirokastrë - lagjia "Kodra e shtufit" Shkodër - lagjia "Qemal Stafa" rruga Zogu I pranë shkollës Ndre Mjeda Tiranë QFPP nr. 1 - rruga "Asim Vokshi" (pranë shkollës Harry Fultz) Tiranë QFPP nr. 4 - Bulevardi "Bajram Curri", pranë shkollës "Besnik Sykja" Vlorë - Zyrë Rajonale e Punësimit (ish shkolla e naftës) Qendra e lëvizshme për zonën verilindore - bulevardi "Bajram Curri", (ish shkolla e rezervave, pranë stacionit për Selitë), Tiranë Korçë - rruga "1 Maji"	Online: 24 orë; E hënë - e enjte, ora 08:00 - 16:30 e premte, ora 08:00 - 14:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
	Ofrohet informacion mbi shërbimin 	Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit 	Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online 	Shërbimi ofrohet tërësisht online 
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Mënyra e pagesës
	-Tarifat vendosen sipas llojit të kursit, kohëzgjatjes së tij si dhe qendrës që e ofron -Të papunët të regjistruar si kërkues pune pranë zyrave të punësimit e përfitojnë shërbimin falas. -Të burgosurit që ndjekin një kurs formimi të ofruar nga qendra në institucionet e vuajtjes së dënimit e përfitojnë falas.	Nuk ka		Në sportelin e një banke, brenda institucionit
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	Qendra e formimit grumbullon aplikimet për kursin deri në plotësimin e numrit minimal për të filluar një kurs të ri. Qendrat hartojnë çdo fillim viti një kalendar vjetor kursesh me afate dhe i bëjnë publike për të gjithë të interesuarit			
10. Çfarë përfitoj?	Certifikatë			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	Pa afat			

12. Ku e marr?	Në sportele ☒	Me postë ☐	E-albania ☐	Me e-mail ☐
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontakto në:		Orari	
	E-albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al SHKP web: www.shkp.gov.al Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118		Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E Hënë- E Premte, ora 08:00- 19:00	
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele ☒	Me postë ☒	Web-i i Institucionit ☐	Me e-mail ☒
	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al			
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	Ligji Nr. 15, datë 16.02.2017, Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë; Ligj Nr. 146, datë 15.12.2015 Për punëkërkesit; Udhëzim Nr. 4, datë 15.12.2016, Për procedurat në zbatim të ligjit nr 146/2015, datë 17.12.2015 Për punëkërkesit; Rregullore Nr. 5, datë 17.03.2016, Për procedurat e regjistrimit, ofrimit të shërbimeve dhe çregjistrimit të punëkërkesve në Zyrën e Punësimit, e ndryshuar;			